



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.05.2020

**NJOFTIM**

**Për mbledhjen Nr. 20, datë 19.05.2020, ora 10:00  
të Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, si dhe VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 19.05.2020, ora 10:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 20 e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

1- Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Favina 1” sh.p.k, për modifikimin e licencës me nr. 402, seria P18, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 06.04.2018, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Voskopoje” me kapacitet te instaluar 1970 kW

2- Mbi fillimin e procedurës për pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “Hec Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019” dhe Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

**KRYETARI I ERE  
Petrit AHMETI**